



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1123 Prot

Tiranë, më 27.10.2022

Nr. 1768 Dosje

VENDIM

PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1080 (31134-02926-80) Regj.Them, të lëshuar më datë 19.05.2022 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr. 1768, kërkesën e kreditorit Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T, ndaj debitorit Shoqërisë "ALBCHROME" Sh.p.k., në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 217, datë 06.10.2021.

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 1050 Prot, datë 18.10.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e Shoqërisë "ALBCHROME" Sh.p.k.

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar nga Përmbarduesi Gjyqësor Altin Vako pranë:

- DRSHTRR Tiranë me shkresën Nr. 1099 Prot, datë 18.10.2022
- Qendrës Kombëtare të Biznesit me shkresën Nr. 1098 Prot, datë 18.10.2022
- Bankave Nivelit II me shkresën Nr. 1100 Prot, datë 18.10.2022

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për Ekzekutimin e plotë të Titullit Ekzekutiv më palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ

Se pas dërgimit të Urdhërit për Vënien e Sekuestros Ekzekutive Nr. 1159 Prot, datë 24.10.2022 pranë "Raiffeisen Bank" sh.a dhe nxjerrjes së llogarisë pranë "Banka Kombëtare Tregtare" sh.a., informohem se e gjithë shuma e detyrimit kishte kaluar në llogarinë e Përmbarduesit Gjyqësor, duke zbatuar vendimin e gjykatës.



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedures Civile dhe te Ligjit Nr. 26/2019, date 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1080 (31134-02926-80) Regj.Them, të lëshuar më datë 19.05.2022 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. DRSHTRR Tiranë të bëjë ç’bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Shoqëria “ALBCHROME” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K11613001M, të cilat mund të jenë bllokuar me anë të shkresës Nr. 1099 Prot, datë 18.10.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit II të bëjnë ç’bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të Shoqërisë “ALBCHROME” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K11613001M, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1100 Prot, datë 18.10.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Biznesit të beje ç’bllokimin e aksioneve apo kredive të Shoqërisë “ALBCHROME” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K11613001M, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1098 Prot, datë 18.10.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO

